



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA E KOSOVO / РЕСПУБЛИКА КООСОВО	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRIJA ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No	01 900-2/24
Nr. i Faqeve Be Stranica No. Pages	01- 23.09.24
PRISHTINË / A No 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	05.09.2024
REFERENC-Ë:	24/900/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"FRUTTI" Sh.p.k- Prizren Fabrikë për prodhimin e lëngjeve, Reçan, Prizren.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "FRUTTI" Sh.p.k., Prizren, Me, Nr. Prot. 24/900/MMPHI dhe ka vendosur si ne Vendim për Leje Mjedisore të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/900/MMPHI

Datë: 05.09.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1.2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori, "FRUTTI" Sh.p.k, Prizren, për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e lëngjeve, pajiset me Leje Mjedisore, në ngastrën nr. 0-71813066-02766-0, zona kadastrale, Pllanjan, Komuna Prizrenit.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Te respektohen kushtet e përcaktuara me Lejet Ujore për shfrytëzim dhe shkarkim të ujit;
 - 2.3. Te mbikëqyrë në vazhdimësi funksionimin e impiantit për trajtimin e ujërave që shkarkohen nga hapësirat e fabrikës dhe prodhimi ;

- 2.4. Të menaxhoj me mbetjet nga prodhimi dhe të tjera;
- 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI-në;
- 2.6. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor që është përgjegjës për mjedis;
- 2.7. Për zgjerim te kapacitetit dhe ndryshim të veprimtarisë, operatori obligohet të njoftoj MMPHI- ne;
- 2.8. Afati i lejes Mjedisore është për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga dita e lëshimit te këtij vendimi.

Ar sy e t i m

Është shqyrtuar kërkesa për Leje Mjedisore për operatorin, "FRUTTI" " Sh.p.k- Prizren Fabrikë për prodhimin e lëngjeve, Reçan, Prizren, për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e Lëngjeve, në ngastrën nr. 0-71813066-02766-0, zona kadastrale Pllanjan-Prizren.

Operatori ka bashkangjitur dokumentacionin:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.16/2384/2-ZSP/263/16 Datë: 19.12.2016;
- Leje Ujore- për Shfrytëzim të ujit me nr.1922/23-ZSP-2023 te lëshuar me dt. 05.12.2023;
- Pëlqim Ujor- për Shkarkim te ujit me Nr. 1923/23-ZSP-2023, te lëshuar me dt. 05.12.2023;

Andaj bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe plotësuar nga pala dhe gjendjes faktike, duke përfshi shikimin në vend nga zyrtarët profesional sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin, dhe Udhëzimit Administrativ te MMPHI- se Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore janë paraqitur kushtet si ne diapozitiv.

Afati i përcaktuar i lejes mjedisore në diapozitiv është përcaktuar, në përputhje nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Prizren;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.